

W  
“*Shqiptar*” minator  
UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

**UNMIK**

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Seanca nr.2002/22  
Prishtinë,më 4 dhjetor 2002, ora 10:10  
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare

**P R O C E S V E R B A L**

Seancën e kryesoi z. Fatmir Sejdiu,anëtar i Kryesisë së Kuvendit.  
Kryesusi konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë,gjithsej 68 dhe shpalli  
të hapur punën e saj.  
Për këtë seancë ishte propozuar ky

**R E N D I D I T Ë S**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Procesverbal nga seanca e kaluar;
- 3.Shqyrtimi i parë i P/ligjit “Për Pyjet e Kosovës-2002/10”;
- 4.Shqyrtimi i dytë i P/ligjit “Për Telekomunikacionin-2002/7”;
- 5.Parashtrimi i pyetjeve.

**1.Miratimi i rendit të ditës.**

Deputetët e Kuvendit miratuan rendin e ditës në formën e propozuar.

**2.Procesverbal nga seanca e kaluar.**

Nuk pati vërejtje në proesverbalin e seancës së kaluar dhe ai u miratua.

**3.Shqyrtimi i parë i P/ligjit “Për Pyjet e Kosovës-2002/10”.**

**Kryesusi** e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqes P/ligin para deputetëve  
të Kuvendit.

**Kryeministri Bajram Rexhepi** në ekspozenë e tij, tha se legjislacioni ekzistues i pyjeve në Kosovë përbëhet nga Ligji për pyjet (1977) i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1986 dhe 87, akteve nënligjore që kanë përcjellë këtë Ligj dhe Rregulloret e UNMIK-ut.

Sipas Ligjit për pyjet, shtoi z. Rexhepi pyjet dhe tokat pujore janë definuar si pasuri me interes të përgjithshëm dhe për shkak të funksioneve që kanë gjëzojnë mbrojtje të vecantë. Si nevojë e kalimit nga ekonomia e planifikuar në ekonominë e tregut dhe mbrojtjes së resurëseve pyjore nga dëmtimet dhe menaxhimet joadekuate, sigurimit të produktivitetit sa më të madh, konsiderohet e domosdoshme nxjerra e Ligjit të ri për pyjet, tha kryeministri Rexhepi.

Kryeministri Rexhepi i bëri një elaborim përbajtjes së P/ligjit, strukturave dhe organeve qeveritare pyjore, fondit për ripërtëritjen e pyjeve si dhe pjesëmarrësit në hartimin e këtij P/ligji, e cila i është bashkangjitur transkriptit.

**Kryesusi** e hapi debatin për shqyrtimin e parë të këtij P/ligji.

**Niman Alimusa** ia bëri disa vërejtje P/ligjit nga aspekti gjuhësor. Ai tha se ky P/ligji i takon asaj sfere të gjuhës të stilit shtetroro-administrativ që kërkon një qasje vërtet serioze. Lëshimet gjuhësore dhe teknike në këtë P/ligj, tha z. Alimusa tregojnë joseriozitetin e hartuesit të tij. Secili formulim është shkruar gabimisht dhe teksti i p/ligjit është i palogjikshëm.

**Tomë Hajdaraj** tha se Komisioni për bujqësi dhe zhvillim rural e ka shqurtuar këtë P/ligj dhe ka pasur disa vërejtje në te. Komisioni, tha ai ka vlerësuar se struktura organizative qeverisëse për pyjet është e stërvngarkuar. Me fondet e krijuara të pyjeve duhet të menaxhojë Ministria e ekonomisë dhe finansave, potencoi z. Hajdaraj.

Poseduesit privat të pyjeve janë të atakuar nga administrata e paraparë sipas këtij P/ligji. Ministrit i janë dhënë funksione të tepërtë, tha z. Hajdaraj dhe duhet të nxerrim Ligj për pyjet dhe jo ministrinë.

**Sebahate Grajcevci** tha se pyjet cdo kund në botë, konsiderohen si pasuri kombëtare. Në emër të grupit parlametar të AAK-së, e përkrah P/ligjin për pyjet në parim, por ai duhet të plotësohet gjatë fazës së shqyrtimit të dytë. Roli i komunave në këtë P/ligj, tha ajo është shumë i marginalizuar. Pronarët privatë të pyjeve janë shumë të kufizuar në shfrytëzimin e pyjeve dhe gjobat janë të palogjikshme.

**Naim Maloku** tha se në Kosovë po bëhet shkatërrimi i pamëshirshëm i natyës dhe pyjeve. Ai përkrahu diskutimin e deputetit Tomë Hajdaraj. Në P/ligj gjobat aqë të mëdha janë të palogjikshme dhe të paarsyeshme. Në funksion të mbrojtjes së pyjeve të Kosovës, z. Maloku propozoi që të hiqen doganat për importimin e lëndëve djegëse, si: drunjët, gazi dhe vajrat djegës për amvisni.

**Esad Dauti** tha se e përkrahë këtë P/ligj, por është shumë i vonuar, ngase po bëhet prerja e pamëshirëshme e pyjeve në Kosovë. Ai këtë e ilustroi me prerjen dhe shkatërrimin e pyjeve në mënyrë të pakontrolluar në komunën e Shtërpçës dhe në disa komuna tjera ku rrugët hapen nëpër mjedis të pyjeve të klasit të parë. Pyjet e Gërmisë, vazhdoi z. Dauti

janë shkatruar .Ai tha se e përkrahë këtë P/ligj, i cili duhet të plotësohet gjatë fazës së shqyrtimit të tij nëpër komisionet përkatëse të Kuvendit.

**Ramadan Kelmendi** tha se shqyrtimi i këtij P/ligji është shumë i rëndësishëm,nga-se me këtë po bëhet përpjekje për mbrojtjen e pasurisë natyrore të Kosovës nga eksploatimi i pakontrolluar i tyre.Z. Kelmendi paraqiti edhe disa vërejtje në këtë P/ligj,si nga aspekti gjuhësor i hartimit të tij dhe shumës së gjobave deri në 10.000 E!

**Zyhrije Maloku** tha se Komisioni për ambient dhe planifikim hapsinor e ka shqyrtuar këtë P/ligj dhe ka dhënë disa vërejtje në te.”Zonat e pashfrytëzuara” në kometencë të cilës ministri janë,pyeti ajo?Të ministrisë së ambientit apo të bujqësisë?Ajo pati edhe disa vërejtje në P/ligj të natyrës gjuhësore të cilat reflektojnë edhe përbajtjen e tij.

**Berat Luzha** tha se ky P/ligji më së paku i plotëson kriteret për të qenë ligj.P/ligji është i përgjithsuar dhe i pakuptueshëm.Ai pati vërejtje edhe të natyrës gjuhësore në këtë P/ligj,si në përdorimin e termave që janë përdorur (“servitutet”) dhe përkthimin e dobët të tij. Komunat nuk duhet të përjashtohen nga menaxhimi dhe përkujdesi i pyjeve,theksoi z.Luzha. Këtë P/ligj,vazhdoi ai duhet përkrahur në parim,por duhet të plotësohet gjatë fazës së shqyrtimit të tij.

**Nekibe Kelmendi** tha se kapitulli i këtij P/ligji që ka të bëjë me ndeshkimet-gjobat duhet të përpunohet në tërsi dhe gjykatata për kundërvajtje duhet t'i shqiptojnë denimet të cilat i parasheh P/ligji.Ajo pati vërejtje se P/ligji nuk i ka caktuar kufijtë e pyjeve të Kosovës dhe shtoi :”kufijtë e pyjeve të Kosovës janë ata kufij që ekzistonin sipas Kushtetutës së vitit 1974”. Mungesën e përcaktimit të qartë të kufijve të pyjëve të Kosovës e ka shfrytëzuar Mali i Zi dhe ka bërë shitjen e pyjeve tona përfundoi znj.Kelmendi.

**Sabit Rrustemi** shfaqi shqetësimin lidhur me mungesën e ministrit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në seancat e Kuvendit për ta paraqitur këtë P/ligj para deputetëve. Në këtë P/ligj,tha ai i janë lënë kompetenca të mëdha ministrit dhe nuk është precizuar roli i komunave.

**Fadil Geci** tha se ky P/ligj është shumë i rëndësishëm për Kosovën,por atë duhet plotësuar,ndryshuar dhe plotësuar gjatë shqyrtimit të tij.Ai pati disa vërejtje konkrete në nenet e P/ligjit të cilat tha ai duhet ndryshuar dhe plotësuar.Në P/ligj duhet të parashihet,vazhdoi ai themelimi i Instituti i Pylltarisë së Kosovës si institut shkencor dhe hulumtues,i cili do të merrej,përvec tjerash edhe me hartimin e planeve menagjuese për pylltari dhe gjueti.

**Haki Shatri** tha se ka vëretje në këtë P/ligj se ai është mjaftë konfuz,kundërthënës dhe i pakuptimët nga aspekti gjuhësor.Nuk janë definuar mirë,tha ai kompetencat dhe fushëveprimitaria e strukturave menagjuese,të cilat duhet të përmirësohen gjatë fazës së shqyrtimit të P/ligjit.

**Mehmet Neziri** tha se ky P/ligj ka një rëndësi të vecantë dhe se është vonuar në nxerrjen e tij,ngase është bërë eksploatimi i pamëshirshëm i pyjeve tona dhe prehen drunjë

industrial pér nxemje.Kompetencat e qeverive komunale,vazhdoi ai nuk janë parashikuar me këtë P/ligj pér mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve.Ai pati vërejtje në shumën e gjobave ku parashitet deri në 50.000E,por nuk parashihet minimum i tyre.  
Në parim e pérkrahu këtë p/ligj.

**Isuf Sutaj** tha se në P/ligj nuk janë definuar komptenecat në mes Agjencionit kosovar të pyjeve dhe struktuarave regionale pér menagjimin e pyjeve.Ai shfaqi shqetësimet lidhur me shkatrimin e pamëshirëshëm të pyjeve të Kosovës dhe se është vonuar me nxjerrjen e këtij Ligji i cili do të kishte ndikuar në mbrojtjen e tyre.

**Blerim Baruti** tha se ky P/ligj mundëson administrimin,mbrojtjen shtimin dhe trajtimin e pyjeve të Kosovës.Me kët Ligj do të realizohet edhe ruajtja e mjedisit,prodhimi material nga druri dhe i prodhimeve tjera pyjore.Ky P/ligj duhet të plotësohet gjatë fazës së shyrtimit të tij.

**Gani Koci** tha se P/ligji është hartuar shumë dobët si nga aspekti profesional-juridik ashtu edhe nga aspekti gjuhësor.P/ligji nuk e ka definuar qartë mënyrën e menagjimit të pyjeve.Nuk parashihet në P/ligj roli i komunave në menaxhimin e pyjeve dhe se administrata qendrore pér menagjimin e pyjeve është e stërngarkuar.

**Sabri Hamiti** tha se pérkrah diskutimet e deputetëve Shatri,Luzha dhe N.Kelmendi. Përcaktimi i kufijëvë të pyjeve të Kosovës nënkupton edhe problemin e Kosovës,dhe si pasojë e kësaj ndodhë që fqinjët tanë,t'ia shesin shiptarëve tokat tona.  
Në aspektin gjuhësor,vazhdoi z.Hamiti P/ligji është hartuar dobët dhe apeloi tek hartuesit e P/ligjeve që ta përmirësojnë këtë dukuri e cila po i përcjell të gjitha P/ligjet.

Pas debatit të zhvilluar lidhur me këtë P/ligj,kryesusi atë e hodhi në votim

---kush është pér miratimin e tij?---66,  
---kush është kundër ?-----0,  
---kush abstenon?----- 0.

**Kryesusi** konstaoti se P/ligji “Për Pyjet e Kosovës-2002/10” **u miratua** në parim dhe ai duhet të shqyrtohet nëpër komisionet përkatëse të Kuvendit.

#### **4.Shqyrtimi i dytë i P/ligjit “Për Telekomunikacion-2002/7”.**

**Kryesusi** dha një pauzë të seancës,gjatë së cilës komisionet e Kuvendit duhet t'i shqyrtonin dhe harmonizonin disa amendamente në këtë P/ligj.  
Pas pauzës,kryesusi ftoi kryetarin e Komisionit pér buxhet që të raportojë pér punën e atij Komisioni.

**Haki Shatri** tha se Komisioni pér buxhet gjatë pauzës i ka shqyrtuar dy materiale që i kanë arritur.Sygjerimet e një deputeti të koalicionit “Kthimi” Komisioni i ka refuzuar,ngase ato nuk ishin amendamente dhe komisioni nuk ka pasur cka të

shqyrtojë.Qëndrimet e Komisionit për buxhet përputhen me ato të komisionit finkSIONAL për atë pjesë të materialit që kanë shqyrtuar,përfundoj z.Shatri.

**Mahir Yagjilar** tha se vlersimet e Komisionit për interesat dhe të drejtat e komuniteteve janë se ky P/ligj nuk dëmton interesat e komunitetev në Kosovë dhe ne kemi bërë një propozim-ndryshim në nenin 7.1 të P/ligjit për të cilin duhet të deklarohen deputetët e Kuvendit.

**Edita Tahiri** tha se Komisioni për telekomunikacion gjatë shqyrtimit të P/ligjit ka mbajtur një dëshmi publike ku ekspertët e kësaj lëmie kanë dhënë vërejtjet dhe sygjerimet e veta në këtë P/ligj.Pas shqyrtimit të P/ligjit,Komisioni ka ardhur në përfundim se disa cështje parimore duhet të ndryshohen në te,që kanë të bëjnë me kompetencat mes Kuvendit të Kosovës,Ministrisë së Transporteve dhe Agjencionit për Mirëbesim të Kosovës.Komisioni ka bërë disa propozime,vazhdoi znj.Tahiri lidhur me Bordin mbikqyrës i cili duhet ta mbikqyrte veprimtarinë e PTK-së;tenderët të shpallen në afat prej 12 muajsh;licensimet të jepen në afat kohorë prej 3 vjetësh;30% e fitimit të ndahet për investime në telefoninë fikse të Kosovës. Znj.Tahiri pati edhe disa propozime të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

**Fatmir Limaj** tha se para deputetëve gjenden dy propozimet e komisioneve të cilat nuk janë të harmonizuara dhe për të cilat është dashur që të hapet debati.Ai pati vërejtje në mungesën e ministrit të Telekomunakcionit dhe Transporteve,i cili është dashur të prezentojë në seancë gjatë shqyrtimi të këtij P/ligji.Z.Limaj tha se përkrah qëndrimet e Komisionit të Telekomunikacionit dhe shtoi se duhet të bëhet një liberalizim i kontrolluar i tregut të telefonisë.

**Bujar Dugolli** tha se gjatë shqyrtimit të P/ligjeve komisionet funksionale të Kuvendit duhet ta jepin kontributin e vet,ngase ato mësë miri e njohin materien të cilën e rregullon Ligji.Komisionet kryesore duhet të merren me fushëveprimtarinë e vet që e kanë të përcaktuar me Rregullorën e punës së Kuvendit.Z.Dugolli tha se përkrah qëndrimet e Komisionit të Telekomunikacionit me përjashtim të amendamentit 16,nenit 7.1..

**Kryesusi** i hodhi në votim amendamentet e Komisionit për telekomunikacion nen për nen.

Amendamenti 1,neni 2-miratohet.

Amendamenti 2,neni 2-miratohet.

Amendamenti 3,neni 2-miratohet.

Amendamenti 4,neni 2-miratohet.

Amendamenti 5,neni 3(1) (c) (ii)-miratohet.

Amendamenti 6,neni 3(1) (c) (iii)-miratohet.

Amendamenti 7,kapitull i ri,pas kapitullit të tretë-miratohet.

Amendamenti 8,neni 3(3)-miratohet.

Amendamenti 9,neni 3(4)-miratohet.

Amendamenti 10,neni 4(1)-miratohet.

Amendamenti 11,neni 4(4)-miratohet.  
Amendamenti 12,neni 5(4) i korigjuar-miratohet.  
Amendamenti 13,neni 5(8)-miratohet.  
Amendamenti 14,neni 6(2)-miratohet.  
Amendamenti 15,neni 6(4)-miratohet.  
Amendamenti 16,neni 7(1)-refuzohet,në vend të tij miratohet amendamenti i Komisionit për interesat dhe të drejtat e komuniteteve.  
Amendamenti 17,neni 7(2)-refuzohet.  
Amendamenti 18,neni 7(4)-miratohet.  
Amendamenti 19,neni 7(5)-miratohet.  
Amendamenti 20,neni 9(1)-refuzohet.  
Amendamenti 21,neni 9(1)-refuzohet.  
Amendamenti 22,neni 11(2)-miratohet.  
Amendamenti 23,neni 11(8)-refuzohet.  
Amendamenti 24,neni 11(8)-miratohet.  
Amendamenti 25,neni 13(1)-miratohet.  
Amendamenti 26,neni 15(4)-miratohet.  
Amendamenti 27,neni 17(1)(a)-miratohet.  
Amendamenti 28,neni 17-refuzohet.  
Amendamenti 29,neni 34-refuzohet.  
Amendamenti 30,neni 48(1)-refuzohet.  
Amendamenti 31,neni 48(2)-refuzohet.  
Amendamenti 32,neni 48(4)-refuzohet.  
Amendamenti 33,neni 49-refuzohet.  
Amendamenti 34,neni 56(6)(d)-miratohet.  
Amendamenti 35,neni 65-refuzohet.  
Amendamenti 36,neni 66-refuzohet.  
Amendamenti 37,neni 66(4)-miratohet.  
Amendamenti 38,neni 75(3)-miratohet.  
Amendamenti 39,neni 78-miratohet.

Kryesusi e hodhi në votim P/ligjin “Për Telekomunikacion-2002/7” me amendamentet e miratuara në te.

Rezultati i votimit ishte:

Për-----68,  
Kundër----0,  
Abstenime—0.

**Kryesusi konstatoi miratimin e P/ligjit “Për Telekomunikacion-2002/7”.**

Seanca plenare përfundoi në orën 15:45 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  
akademik Nexhat Daci